

# **PROJEKT MARRËVESHJA E BASHKIMIT ME PËRTHITHJE**

**MIDIS VODAFONE ALBANIA SHA**

**DHE**

**ABCOM SHPK**



Sot, në datën \_\_\_\_./\_\_\_\_.2020 (dy mijë e njëzet), palët e mëposhtme nënshkruan këtë Marrëveshje sipas kushteve të mëposhtme:

**“Vodafone Albania” SH.A**, një shoqëri aksionare e themeluar dhe që vepron sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Numër Unik të Identifikimit K11715005L, me seli në adresën: Autostrada “Tiranë-Durrës”, Rruga “Pavaresia”, Nr. 61, Kashar, Tiranë

(këtu e në vijim referuar si **“Vodafone”** ose, **“Shoqëria Përthithëse”**)

**“ABCOM” SH.P.K**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me Numër Unik të Identifikimit: K11308001B, me seli në adresën: Autostrada “Tiranë-Durrës”, Rruga “Pavaresia”, Nr.61, Kashar, Tiranë

(këtu e në vijim referuar si **“ABCOM”** ose, **“Shoqëria e e Përthithur”**)

Shoqëria Përthithëse dhe Shoqëria e e Përthithur janë referuar këtu e në vijim individualisht si **“Pala”** dhe së bashku **“Palët”** ose **“Shoqëritë e Bashkuara”**

## **MEQENËSE**

- A. Më 11.03.2020, Vodafone dhe ABCOM përfunduan transaksionin e shitblerjes së aksioneve sipas të cilit, që nga data 11.03.2020 Vodafone është pronar i 100% të kapitalit të ABCOM dhe ABCOM është bërë një degë në pronësi të plotë të Vodafone;
- B. Vodafone, si aksionere e vetme e ABCOM, ka vlerësuar paraprakisht mundësi të ndryshme për racionalizimin e operacioneve të Vodafone dhe ABCOM, duke marrë në konsideratë qëndrueshmërinë aktuale dhe të ardhshme si dhe rendabilitetin e operacioneve të biznesit të të dy subjekteve. Pas këtij vlerësimit, Vodafone i propozoi aksionerëve të saj bashkimin e ABCOM me Vodafone nëpërmjet një bashkimi me përthithje në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare;
- C. Pas këtij propozimi, mbledhjet përkatëse të Vodafone dhe ABCOM të mbajtura përkatësisht më 27 Gusht 2020 dhe 1 Tetor 2020, kanë vendosur të autorizojnë fillimin e procedurave të bashkimit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në draft marrëveshjen e bashkimit dhe projektin e bashkimit që do të përgatitej nga drejtuesit përkatës të Shoqërive të Bashkuara dhe në përputhje me ligjet në fuqi të Republikës së Shqipërisë; Një kopje e këtyre vendimeve është bashkëlidhur në Shtojcën 1 të këtij dokumenti;
- D. Kapitali i regjistruar i Vodafone nuk do të zmadhohet si rezultat i bashkimit, prandaj kjo Marrëveshje dhe ky Bashkim nuk do të përfshijnë dispozita mbi raportin e këmbimit të aksioneve, shumën e ndonjë pagese në para ose kushtet e ndarjes së aksioneve në Shoqërinë Përthithëse.
- E. ABCOM është aksioneri i vetëm i shoqërive të renditura në Shtojcën 2 të këtij dokumenti, të cilat si rezultat i Bashkimit dhe me Mbylljen, të gjitha do të bëhen degë në pronësi të plotë të Vodafone.

## **PALËT NËPËRMJET KËSAJ MARRËVESHJEJE BIEN DAKORD SA MË POSHTË VIJON:**

### **PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI**

1.1. Në këtë Marrëveshje (përfshirë deklaratat dhe shtojcat) përveç rasteve kur konteksti e parashikon ndryshe ose përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në vijim, termat e mëposhtëm kanë kuptimin e mëposhtëm:

<b>“Marrëveshje”</b>	është kjo Marrëveshje e Bashkimit me Përthithje – duke përfshirë, si pjesë përbërëse të saj, deklaratat e mësipërme dhe shtojcat bashkëlidhur të cilat janë nënshkruar dhe shkëmbyer nga edhe midis Vodafone dhe Abcom;
<b>“Autoriteti”</b>	është cdo gjykatë ose autoritet gjyqësor kombëtar ose i huaj, ose organ, departament, agjenci, komision, autoritet qeveritar, administrativ ose rregullator, organ, agjenci, komision, autoritet.
<b>“Mbyllja”</b>	është data në të cilën bashkimi bëhet efektiv ndërmjet palëve në përputhje me nenin 6 dhe, në mënyrë të vecantë, ekzekutimi dhe shkëmbimi i të gjitha dokumenteve dhe zbatimi dhe përmbushja e të gjitha detyrimeve, të cilat duhet përkatësisht të ekzekutohen dhe shkëmbehen dhe të zbatohen në kuadrin e mbylljes për të mundësuar realizimin e bashkimit;
<b>“Data e Mbylljes”</b>	është data kur do të ndodhë Mbyllja, në përputhje me nenin 6.4;
<b>“Ligji për Shoqëritë”</b>	është ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
<b>“Deklaratat e Mbylljes”</b>	ka kuptimin që parashikohet në nenin 6.3;
<b>Data e fundit e Kontabilitetit</b>	ka kuptimin që parashikohet në nenin 3.1;

<b>“Kodi i Punës”</b>	është Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Mbi Kodin e Punës”, i ndryshuar;
<b>“Bashkimi”</b>	është Bashkimi me Përthithje i Shoqërive të Bashkuara;
<b>"Bilanci i Hapjes"</b>	ka kuptimin e përcaktuar në Nenin 3.2.
<b>“Aktive dhe Pasivet e Transferuara”</b>	janë të gjitha aktivet dhe pasivet që transferohen nga Shoqëria e Përthithur tek Shoqëria Përthithëse sikundër përshkruhet në këtë Marrëveshje në Nenin 4.

## 1.2. Në këtë Marrëveshje:

- 1.2.1 Cdo statut ose dispozitë staturore i referohet statutit ose dispozitës staturore të ndryshuar, modifikuar ose ri-miraturar ose të dyja herë pas here (qoftë para ose pas datës së kësaj Marrëveshjeje të Bashkimit me Përthithje) dhe cdo legjislacion tjetër të parashikuar sipas statutit ose dispozitës staturore (qoftë para ose pas datës së kësaj Marrëveshjeje të Bashkimit me Përthithje).
- 1.2.2 Një klauzolë ose shtojcë, përveç se kur parashikohet ndryshe nga konteksti, i referohet një klauzole ose shtojcë të kësaj Marrëveshjeje të Bashkimit me Përthithje.
- 1.2.3 Nëse nuk parashikohet ndryshe nga konteksti, numri njëjës do të përfshijë numrin shumës dhe anasjelltas.
- 1.2.3.1 Një gjini do të përfshijë gjininë tjetër.
- 1.2.3.2 Ora e ditës është ora në Tiranë, Shqipëri.
- 1.2.3.3 Titujt e kësaj Marrëveshjeje të Bashkimit nuk do të cenojnë interpretimin ose kuptimin.
- 1.2.3.4 Shtojcat janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje dhe rrjedhimisht janë efektive.

## 2. OBJEKTI I MARRËVESHJES: BASHKIMI ME PËRTHITHJE

- 2.1. Objekti i kësaj Marrëveshjeje është bashkimi me përthithje i ABCOM nga Vodafone sipas termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje.
- 2.2. Në zbatim të nenit 220 të Ligjit për Shoqëritë, Abcom do të transferojë nëpërmjet bashkimit tërësisht të gjitha aktivet dhe pasivet e saj dhe ekzistenca më vete e Abcom do të përfundojë. Vodafone do të jetë Shoqëria Përthithëse dhe do të vazhdojë ekzistencën e saj nën emrin e saj të regjistruar dhe tregtar: “Vodafone” SH.A.

## 3. EFEKTIVITETI KONTABËL

- 3.1. Tërësia e aktiveve dhe pasiveve të ABCOM, të cilat do të transferohen tek Vodafone, do të bazohen në bilancin e audituar të ABCOM dhe Vodafone më **31 Dhjetor 2020** (“**Data e Fundit e Konatibilitetit**”)
- 3.2. Vodafone do të aplikojë opsionin për konsolidimin retrospektiv, prandaj bilanci i hapjes pas bashkimit të Vodafone do të paraqitet si rezultat i bashkimit të njëkohshëm të bilancit dhe gjëndjes së pasqyrës së të ardhurave të Abcom në Vodafone duke filluar nga data 01/01/2021 (“**Bilanci i Hapjes**”). Çdo ndryshim, përmirësim dhe korrigjim i Bilancit të Hapjes i realizuar ndërmjet Datës së Fundit të Kontabilitetit dhe Datës së Mbylljes (nëse ka) do të raportohet dhe miratohet nga mbledhjet përkatëse të aksionerëve të të dy Shoqërive të Bashkuara.

#### **4. VIJUSHMËRIA DHE AKTIVET E TRANSFERUARA**

- 4.1. Në fuqi nga Data e Mbylljes, Vodafone do të jetë pasardhësja, nëpërmjet bashkimit me përthithje e Abcom në çdo dhe të gjitha kontratat, aktet dhe marrëdhëniet në të cilat Abcom është palë, qoftë ekzistuese ose në të ardhmen. Rrjedhimisht, të gjitha aktivet dhe detyrimet, duke përfshirë të gjitha aktivet materiale dhe jo materiale, të gjitha tepricat kreditore, si dhe të gjitha pronat e paluajtshme, marrëdhëniet kontraktuale dhe marrëdhëniet të tjera juridike dhe pozicione juridike të cfarëdo lloji, të arkëtueshme dhe detyrimet, detyrimet potenciale dhe të ardhurat e ardhshme dhe të kushtëzuara te Abcom, do të transferohen tek Vodafone (“**Aktivët dhe Pasivët e Transferuara**“), duke marrë parasysh çdo ndryshim që ndodh deri në datën e mbylljes.
- 4.2. Aktivët dhe Pasivët e transferuara do të përfshijnë, por nuk do të kufizohen në sa më poshtë vijon:
- (i) Cdo dhe të gjitha aktivët dhe të drejtat mbi pasuritë e luajtshme ose të paluajtshme, aktivët materiale dhe jo materiale, pa asnjë kufizim ose përjashtim, të cilat i përkasin ose do t’i përkasin ABCOM;
  - (ii) Të gjitha markat tregtare, modelet e dizajnit, patentat, njohurit, ekspertizën dhe të drejtat e tjera intelektuale të ABCOM;
  - (iii) Licenca, koncesione, autorizime dhe të drejta të ngjashme të ABCOM;
  - (iv) Bazën e klientëve të ABCOM;
  - (v) Cdo kontratë qiraje, sigurimi, furnizimi, shitje, konsultimi, kontrata shërbimi dhe kontratat në të cilat ABCOM është palë, qoftë të lidhura tashmë ose që janë aktualisht në proces negociimi;
  - (vi) Cdo kredi, borxh, depozitë të cdo lloji të krijuar nga ABCOM;
  - (vii) Cdo dhe të gjitha të drejtat që lidhen më ndonjë dhe të gjitha detyrimet e vendosura ndaj ABCOM;
  - (viii) Cdo kërkesë, mosmarrëveshje, padi dhe procedurë kundrejt cdo Autoriteti ku ABCOM është palë;
  - (ix) Cdo dhe të gjitha pasivët dhe detyrimet që i atribuohen ABCOM, duke përfshirë detyrimet potenciale dhe detyrimet e ardhshme te Abcom të cilat kanë ndodhur tashmë;

- 4.3. Aktivët dhe pasivët tatimore të ABCOM që rezultojnë në pasqyrat financiare të ABCOM në Datën e Fundit të Kontabilitetit do të transferohen në Vodafone njësoj si çdo lloj tjetër i aktiveve dhe pasiveve.
- 4.4. Nëse pëlqimi i një kreditori ose i një pale të tretë është i nevojshëm për transferimin e aktiveve të caktuara, ABCOM dhe Vodafone do të përpiqen, ta sigurojnë atë;
- 4.5. Vodafone do të marrë në zotërim të gjitha librat, korrespondencën, të dhënat operative dhe të dhëna të tjera të biznesit që ruan dhe mban ABCOM. Vodafone gjithashtu do të marrë në zotërim cdo dhe të gjith instrumentet dhe dokumentat e nevojshme për të paraqitur të drejtat që i janë transferuar asaj. Vodafone do të ruaj librat, korrespondencën, të dhënat operative dhe të dhënat e tjera të biznesit të ABCOM përgjatë periudhës ligjore të ruajtjes.
- 4.6. Të gjitha regjistrimet, shënimet, titujt dhe/ose shënimet në lidhje me ABCOM në Zyrën e Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme, Regjistrin e Barrës Siguruese, ose ndonjë regjistër tjetër që mbahet nga cdo Autoritet do t'i transferohen Vodafone në Datën e Mbylljes nëpërmjet Bashkimit me përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Vodafone do të jetë pasuesi i ABCOM në cdo dhe të gjitha të drejtat, kompetencat dhe marrëdhëniet që kanë të bëjnë me ABCOM dhe që rrjedhin nga dispozitat e akteve ligjore dhe /ose nënligjore. Cdo dhe të gjitha barrët, kolaterale ekzistuese dhe/ose garancitë e krijuara në favor të ABCOM do të vazhdojnë të jenë të vlefshme, në favor të Vodafone si pasardhës e ABCOM dhe të zbatueshme sipas klasifikimit të tyre.
- 4.7. Me transferimin e të gjitha të drejtave, aktiveve dhe pasiveve të ABCOM në Vodafone, Vodafone do të gëzojë të gjithë të drejtën për të ngritur kërkesa në lidhje me aktivet dhe ka detyrimin t'u përgjigjet të gjitha pretendimeve që palët e treta mund të ngrenë *vis-a-vis* Shoqërisë së Përthithur.
- 4.8. Me Mbylljen e Bashkimit, të gjitha degët e ABCOM në Shtojcën 3 dhe degët e reja të ABCOM të blera ndërmjet datës së kësaj Marrëveshjeje dhe Datës së Mbylljes (nëse ka), do të bëhen degë në pronësi të plotë të Vodafone.

## **5. KUSHTET PËR REALIZIMIN E MBYLLJES**

- 5.1. Përfundimi i transaksionit të Bashkimit të parashikuar në bazë të kësaj Marrëveshjeje është subjekt dhe kushtëzohet nga plotësimi dhe përmbushja e kushteve të mëposhtme përpara Mbylljes:
- i. Vendimi i Asamblesë së të dyja Shoqërive të Bashkuara e miratuar të paktën një muaj pas datës së publikimit të kësaj Draft Marrëveshjeje të Bashkimit në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me nenin 216.3 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
  - ii. Dhënia e miratimit ose konfirmimit të Bashkimit nga të gjitha Autoritetet në Shqipëri dhe realizimi i të gjitha njoftimeve të nevojshme të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, duke përfshirë por pa u kufizuar në Autoritetin e

Komunikimeve Postare dhe Elektronike (“AKEP”), Agjencinë e Mediave Audiovizive (“AMA”), Autoritetin e Konkurrencës në Shqipëri.

## 6. MBYLLJA

- 6.1. Mbyllja do të bëhet në selinë qendrore të Vodafone në Tiranë sa më shpejt që të jetë e mundur, pas përmbushjes së kushtet paraprake për Mbylljen, ose në cdo datë tjetër ose në cdo vend tjetër ku palët do të dakordësojnë në mënyrë reciproke;
- 6.2. Në ose përpara datës së Mbylljes, Palët do të realizojnë nënshkrimin dhe dorëzimin e dokumentave të mëposhtme:
  - i. Dorëzimin e vendimeve të mbledhjes së asamblesë së Vodafone dhe Abcom ku miratohet Mbyllja e Transaksionit të Bashkimit, Marrëveshjes së Bashkimit, dhe dokumentet përkatëse dhe/ose çdo dokument tjetër pararendës të kushteve, nëse ka;
  - ii. Shkresat e dorëheqjes dhe/ose revokimit të administratorit (ëve) dhe/ose anëtarve të organeve drejtuese/përfaqesuese të Abcom.
- 6.3. Pas nënshkrimit dhe/ose dorëzimit të dokumenteve të parashikuara në nenin 6.2 më sipër, Palët do të nënshkruajnë Deklaratën e Mbylljes substancialisht në formën e Shtojcës 3 e cila dëshmon përmbushjen e cdo dhe të gjitha kushteve dhe detyrimeve të Palëve për efektivitetin e Bashkimit.
- 6.4. Bashkimi do të bëhet efektiv në datën e regjistrimit të Bashkimit në regjistrin tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me Ligjin për Shoqëritë (“**Data e Mbylljes**”).

## 7. SHOQËRIA; TË DREJTAT DHE PËRFITIMET E VECANTA

- 7.1. Statuti ekzistues i Vodafone, i ndryshuar, nëse është e nevojshme dhe i miratuar rregullisht, do të jetë Statuti i Shoqërisë Përthithëse.
- 7.2. Anëtarët e organeve të shoqërisë të Vodafone në Datën e Mbylljes do të jenë anëtarët e organeve të shoqërisë të Shoqërisë Përthithëse. Administratori dhe/ose anëtarët e organeve drejtuese/të përfaqësimit të ABCOM do të japin dorëheqjen dhe/ose do të revokohen në Datën e Mbylljes.
- 7.3. Nuk ekziston asnjë titullar i obligacioneve të konvertueshme dhe aksioneve preferenciale që preket nga Bashkimi. Nuk jepet asnjë e drejtë e posacme. Aksionarët e Vodafone do të vazhdojnë të gëzojnë të njëjtat të drejta edhe pas Bashkimit.

## 8. MBROJTJA E KREDITORIT

8.1. Kreditorët e ABCOM janë të mbrojtur në zbatim të nenit 221 të Ligjit për Shoqëritë.

## **9. PASOJAT PËR PUNONJËSIT**

9.1. Pasojat e Bashkimit për punonjësit e ABCOM do të burojnë në bazë të neneve 138, 139 dhe 139/1 të Kodit të Punës.

9.2. Në Datën e Mbylljes, të gjitha kontratat e punës ku ABCOM është pjesëmarrësi si palë në atë kohë, do t'i transferohen në bazë të ligjit Vodafone, e cila do të vazhdojë kontratat e punës të punonjësve të transferuar së bashku me të gjitha të drejtat dhe detyrimet.

9.3. Vodafone do të jetë përgjegjëse për cdo dhe të gjitha detyrimet, përfshirë detyrimet e papaguara – që burojnë nga kontratat e transferuara të punës.

## **10. ZGJIDHJA E KONTRATËS**

10.1. Kjo Marrëveshje do të zgjidhet vetëm në bazë të miratimit me shkrim të të dyja palëve përpara Datës së Mbylljes.

## **11. LIGJI I ZBATUESHËM**

11.1. Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në të gjitha aspektet në përputhje me ligjet dhe cdo dokument tjetër që ka forcën e ligjit në Republikën e Shqipërisë.

11.2. Juridiksioni kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit të Tiranës.

## **12. TË NDRYSHME**

12.1. Paraqitja e kërkesave  
Palët bien dakord që Vodafone dhe ABCOM do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme brenda kompetencave të tyre që duhen për të siguruar dhe garantuar përmbushjen e kushteve të parashtruara në nenin 5.1 (ii) më sipër. Për këtë qëllim, Vodafone duhet të paraqesë pranë cdo autoriteti kompetent cdo kërkesë të miratimit ose njoftimit të nevojshëm për të bërë Bashkimin sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje. Vodafone merr përsipër t'i paraqesë cdo autoriteti të gjitha informacionet dhe/ose dokumentacionin e kërkuar në lidhje me to. Për të shmugur cdo dyshim depozitimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit do të bëhet respektivisht nga të dy, Abcom dhe Vodafone.

12.2. Kostot  
Vodafone do të paguaj kostot në lidhje me Bashkimin dhe në veçanti kostot që lidhen me Mbylljen dhe përgatitjen e të gjithë dokumentacionit ligjërish të detyrueshëm.

12.3. Tërësia e Marrëveshjes



Kjo Marrëveshje (së bashku me të gjitha dokumentet e përmenduar në të, ose të nënshkruara në datën e Mbylljes ose përpara saj) përbën tërësinë e Marrëveshjes dhe dakordësinë midis Palëve në lidhje me përmbajtjen saj dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet, kontratat ose angazhimet e mëparshme lidhur me këtë çështje.

12.4. Amendimi

Asnjë ndryshim i kësaj Marrëveshje nuk do të jetë efektive nëse nuk është bërë me shkrim nga Palët.

12.5. Pavlefshmëria e pjeshme

Nëse një pjesë e kësaj Marrëveshje është ose bëhet e pavlefshme ose jo e detyrueshme për zbatim, Palët janë të detyruara të respektojnë pjesën e mbetura. Palët në këtë rast do të zëvendësojnë pjesën e pavlefshme ose të jo të detyrueshme për zbatim me dispozita të cilat janë të vlefshme dhe të detyrueshme dhe efekti i të cilave, duke pasur parasysh përmbajtjen dhe qëllimin e kësaj Marrëveshje, është në masën më të madhe të mundshme, e njëjtë me pjesën e pavlefshme ose jo të detyrueshme për zbatim.

12.6. Njoftimi

Përveç se kur parashikohet ndryshe në këtë marrëveshje, të gjitha komunikimet do të jenë me shkrim dhe do të dërgohen me telegram, fax ose telex me marrje konfirmimi drejtuar si më poshtë vijon:

**(a) Vodafone**

Adresa: Autostrada “Tiranë-Durres”, Rruga “Pavaresia”, Nr.61, Kashar, Tiranë.

Telefon: +355692223575

Email: [silvana.daku@vodafone.com](mailto:silvana.daku@vodafone.com)

Në vëmendje të: Achillefs Kanaris

**(b) ABCOM**

Adresa: Autostrada “Tiranë-Durres”, Rruga “Pavaresia”, Nr.61, Kashar, Tiranë.

Telefon:+355692220993

Email: [agar.perez@vodafone.al](mailto:agar.perez@vodafone.al), [asistent@abcom.al](mailto:asistent@abcom.al)

Në vëmendje të: Agar Perez Valer, Eni Zyla

12.7. Gjuha dhe Kopjet

Kjo Marrëveshje hartohet në gjuhën Angleze dhe në gjuhën Shqipe, në 4 kopje të njëjta. Në rast të ndonjë mospërputhje midis versioneve, versioni anglisht do të mbizotërojë.

Achillefs Kanaris

---

*Si përfaqësues ligjor i*

**VODAFONE ALBANIA SHA**

Agar Perez Valer

---

Si përfaqësues ligjor i

**ABCOM SHPK**

*SHTOJCA 1*

**Vendimet e Mbledhjeve të Vodafone Albania SHA dhe ABCOM SHPK**

***SHTOJCA 2***

**Filialet e ABCom Shpk**

### ***SHTOJCA 3***

#### **Forma e Deklaratës së Mbylljes**

Kjo Deklaratë e Mbylljes është bërë sot më [●] nga dhe në emër të:

- **“Vodafone Albania” SH.A**, një shoqëri aksionare e themeluar dhe që vepron sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Numër Unik të Identifikimit K11715005L, me seli në adresën: Autostrada “Tiranë-Durrës”, Rruga “Pavaresia”, Nr. 61, Kashar, Tiranë

(këtu e në vijim referuar si **“Vodafone”** ose, **“Shoqëria Përthithëse”**)

- **“ABCOM” SH.P.K**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me Numër Unik të Identifikimit: K11308001B, me seli në adresën: Autostrada “Tiranë-Durrës”, Rruga “Pavaresia”, Nr.61, Kashar, Tiranë

(këtu e në vijim referuar si **“ABCOM”** ose, **“Shoqëria e e Përthithur”**)

Vodafone dhe ABCOM referohen individualisht në vijim si dhe bashkërisht si “**Palët**” ose “**Shoqëritë e Bashkimit**”.

Të gjithë termat me germa të mëdha të përdorura por jo të përkufizuara këtu do të kenë kuptimin që i është dhënë atyre Marrëveshjen e Bashkimit (sic përkufizohet më poshtë).

## HYRJA

- A. Më [●] 2020, Palët kanë lidhur një marrëveshje bashkimi, nëpërjet të cilës Vodafone bashkohet me përthithje me ABCOM (në vijim “**Marrëveshja e Bashkimit me Përthithje**”);
- B. Sipas Marrëveshjes së Bashkimit, mbyllja e bashkimit të lartpërmendur është kushtëzuar me përmbushjen e kushteve të caktuara (“**Kushtet Paraprake**”) si dhe i nënshtrohen kryerjes së disa veprimeve të caktuara (“**Mbyllja**”).
- C. Këto Kushte Paraprake dhe veprimet e Mbylljes janë ndërmarrë ose hequr dorë nga Pala përkatëse sipas Marrëveshjes.

NDËRKOHË QË, duke marrë në konsideratë sa më sipër dhe në përputhje me Marrëveshjen e Bashkimit me Përthithje, Vodafone dhe Abcom deklarojnë sa më poshtë:

## 1. KUSHTET PARAPRAKE

Palët pranojnë se:

- 1.1. Respektivisht, nëpërmjet një vendimi të Ortakut të Vetëm të ABCOM dhe Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve të Vodafone, Palët kanë miratuar vendimin përkatës të paktën një muaj pas datës së publikimit të Marrëveshjes së Bashkimit me Përthithje në regjistrin tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me nenin 216.3 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 1.2. Lejimi ose miratimi ose konfirmimi i Bashkimit nga cdo Autoritet në Shqipëri dhe kryerja e cdo njoftimi të kërkuar nga legjislacioni në fuqi është dhënë ose përfunduar.

## 2. DOKUMENTET E PËRFUNDUARA TË TRANSAKSIONIT

Palët pranojnë se

- 2.1. Vendimet e Ortakut të vetëm të ABCOM dhe të Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve të Vodafone të cilat miratojnë Mbylljen e Transaksionit të Bashkimit, Marrëveshja Përfundimtare e Bashkimit dhe dokumentet përkatëse dhe/ose cdo dokument të kushteve paraprake, nëse ka, janë dorëzuar;
- 2.2. Letrat e dorëheqjes dhe/ose revokimit të të administratorëve dhe/ose anëtarëve të organeve drejtuese/përfaqësuese të ABCOM, janë lëshuar dhe dorëzuar rregullisht.

### **3. DATA E MBYLLJES**

3.1. Data e Mbylljes do të jetë data e regjistrimit të Bashkimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Nga ky moment, Vodafone do të jetë pasardhësi, si pasojë e Bashkimit, i ABCOM në të gjitha të drejtat dhe detyrimet dhe Abcom do të pushojë së ekzistuari si një subjekt i veçantë juridik.

### **4. TË NDRYSHME**

4.1. Për shmangien e dyshimit, efekti juridik i kësaj Deklarate të Mbylljes do të kufizohet në përcaktimin e Datës së Mbylljes dhe do të shërbejë si provë për përmbushjen e ndonjë dhe të gjitha kushteve dhe detyrimeve të Palëve për vlefshmërinë e Bashkimit. Nënshkrimi i Deklaratës së Mbylljes nuk do të kufizojë ose cenojë në ndonjë mënyrë të drejtat e Palëve që lindin sipas Marrëveshjes së Bashkimit ose sipas ligjit të zbatueshëm.

4.2. Përveç kur specifikohet ndryshe këtu, termat e përdorur në këtë Deklaratë të Mbylljes do të kenë kuptimin që i është dhënë në Marrëveshjen e Bashkimit me Përthithje.

4.3. Në masën që është e zbatueshme në këtë Deklaratë të Mbylljes, dispozitat e Marrëveshjes së Bashkimit me Përthithje do të zbatohen *mutatis mutandis*.

**ABCOM SH.P.K**

Nga: \_\_\_\_\_

Si përfaqësues i ABCOM SH.P.K

**Vodafone Albania SH.A**

Nga: \_\_\_\_\_

Si përfaqësues i Vodafone Albania SH.A